



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures



Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Dhjetor, 2016

Aktivitete e angazhime të shumta të SBASHK-ut gjatë vitit 2016

Përfaqësim dinjitoz kudo në Kosovë dhe jashtë vendit



Lexues të nderuar SBASHK-u e shënon vitin 2016 me shumë aktivitete e angazhime në shërbim të anëtarësisë dhe realizimit të kërkesave të tyre legjitime. Po ashtu SBASHK-u në shenjë respekti për angazhimet dhe zërin e fuqishëm sindikal është ftuar në shumë takime me rëndësi në vend dhe në nivelin ndërkombëtar. Për ju do të kthejmë kujtesën në ngjarjet më të rëndësishme.

Takime me Kabinetin Qeveritar të Kryeministrit Mustafa ... (faqe 5-7)

SBASHK-u në mesin e sindikatave të arsimit të 44 shteteve evropiane

Konferencë zgjedhore e ETUCE-së



Mes 44 sindikatave nga shtetet e Evropës edhe SBASHK-u ishte pjesëmarrës në Konferencën zgjedhore ... (faqe 8)

SBASHK-u kremtoi edhe 5 tetorin - Ditën Botërore të Mësuesit

Konferencë tematike në lartësim të personalitetit të mësuesit



Këtë vit SBASHK-u, krahas shumë aktiviteteve në shënim të ditës kombëtare të mësuesit dhe ... (faqe 8-9)

SBASHK-u kremtoi në mënyrë madhështore ditën e mësuesit

Kujtesë për njerëzit e dijes e pendës

Një aktivitet që është lavdëruar nga të gjithë ishte ceremonia festive për nder të 7 Marsit- ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe.(faqe 9-10)

Për numrin festiv flet stafi i SBASHK-ut

Çdo ditë në shërbim të anëtarësisë

Ymer Ymeri,
Nezafete Jakupi,
Vlora Rexhepi Berisha,
Afërdita Mirena-Ahmeti,
Blendor Shatri

.... (faqe 3-4)



Editorial

Sa shpejt ikin ditët



Në takime me kolegët kudo në Kosovë pas bashkëbisedave për angazhimet sindikale ndalemi e flasim miqësisht dhe shpalosim

kujtime nga ditët e kaluara. Të gjithë spontanisht e sikur me një zë e pranojmë se ditët po ikin shpejt. Këtë realitet e forcon dhjetori dhe festa e Vitit të Ri. Të gjithë e thonë “Eh, ja shkoj edhe ky vit”. Ky moment të bën të kujtosh e të mendosh se cilat ishin momentet kyçe dhe mundohesh të bësh një vlerësim për arritjet, sfidat dhe detyrat e kryera e të pakryera. Kur shpalos kujtesën dhe sheh se ditët nuk të kanë ikur edhe kot ndihesh mirë dhe vitin tjetër e pret me guxim sepse do të vazhdosh me arritje e suksese.

SBASHK-u në këtë vit, që po ik, vazhdojë të jetë zë i fuqishëm i të punësuarve në arsim. Kishte shumë kërkesa e sfida dhe ato u munduam t'i realizojmë e t'i tejkalojmë me urtësi e me dialog, pa përjashtuar as edhe një herë edhe veprimet sindikale. Me punë, korrektësi e sinqeritet krijuam respekt të të gjithë. Në këtë vit në çdo Konferencë e takim që fliste për arsimin ishte SBASHK-u.

SBASHK-u në këtë vit arriti të shtojë bashkëpunimin edhe me sindikatat simotra në Ballkan, Evropë e kudo në botë. Kudo gëzojmë respekt dhe na është

shprehur gatishmëria për bashkëpunim në shërbim të forcimit të zërit sindikal.

Unë në cilësinë e kryetarit edhe gjatë gjithë këtij viti jam munduar të përfaqësoj sa më mirë SBASHK-un kudo në takime e angazhime sa më mirë SBASHK-un. Edhe në këtë vit kemi shënuar arritje, por kanë mbetur edhe sfida. Jam ndjerë krenar dhe i fortë në dialog me institucionet e Kosovës falë unitetit dhe përkrahjes së mijëra anëtarëve të SBASHK-ut nga e tërë Kosova. Kjo më bën krenar dhe premtoj se edhe në vitin 2017 do të vazhdoj me angazhime pa u ndalur në përpjekje për të realizuar kërkesat legjitime të anëtarësisë dhe për ta përfaqësuar në mënyrën më të denjë SBASHK-un kudo që e kërkon koha. I përgëzoj koleget e kolegët kudo në Kosovë për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë dhe urimin për Vitin e Ri për shëndet të mirë e suksese të reja të gjithë të punësuarve në arsim e shoqëroj me thënien ” Ejani bashkë e në SBASHK”.

SBASHK-u arriti me punë e përkushtim të zgjidh shumë çështje të rëndësishme për të punuarit në arsim dhe për të pensionuarit. Kërkesat nuk i themi sa për t'i thënë, por këmbëngulim në realizimin e tyre pa e ndalur aktivitetin as edhe për një moment. Vlëra më madhe e SBASHK-ut është përkushtimi dhe uniteti i anëtarësisë. Në

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



SBASHK çdo ditë e çdo muaj shtohet numri i anëtarëve kjo na bën krenar sepse kemi besimin e të punësuarve në arsim, por jemi edhe të vetëdijshëm se kjo krijon obligime shtesë dhe ne këto obligime do t'i kryejmë të ndihmuar e të përkrahur nga mijëra të punësuar në arsim nga çerdhet e deri të Universitetet. SBASHK-u

është krenar dhe zë i fuqishëm sindikal. Do të jemi edhe më të mirë në vitin që po vjen dhe prandaj krejt në fund të këtij shkrimi GËZUAR kolege e kolegë sindikalistë kudo jeni. Paçi shëndet të mirë, fat dhe suksese edhe më të mëdha në vitin 2017.

GËZUAR

Intervista

Për numrin festiv flet stafi i SBASHK-ut

Çdo ditë në shërbim të anëtarësisë



Ymer Ymeri, Menaxher për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm

Është kënaqësi e krenari të jesh pjesë e SBASHK-ut dhe të angazhohesh vazhdimisht në shërbim të anëtarësisë. Me punë e përkushtim që nga themelimi i SBASHK-ut jam munduar të kontribuoj në realizmin

e misionit të SBASHK-ut dhe në zgjidhjen e kërkesave të anëtarësisë në dialog me institucionet. Edhe këtë vit SBASHK-u ka shënuar arritje dhe u dallua me angazhimet e vazhdueshme në realizmin e kërkesave të anëtarësisë. Ndjem krenar që jam pjesë e këtyre angazhimeve dhe besimi i madh dhe uniteti shembullor i gjithë anëtarësisë së SBASHK-ut na obligon që të vazhdojmë me angazhimet dhe me përpjekjet për arritje e suksese edhe më të mëdha. Të gjithë anëtarëve të SBASHK-ut iu uroj suksese e arritje të reja dhe gëzuar Viti i RI.



Përsëritet,

Quhem Nezafete JAKUPI-Pozita:
Libërmbajtëse në SBASHK

Të përshkruash punën e një viti të tërë me pak fjalë është pothuajse e pamundur, por do të mundohem.

Të jesh pjesë e stafit të SBASHK-ut për 12 vite me radhë, e të

vazhdosh me më shumë motiv nga viti në vit, kjo është meritë e një menaxhimi të shkëlqyer në këtë organizatë. Të gjithë kërkojnë të punojnë në një mjedis që të vlerësojnë dhe të frymëzojnë, të çmojnë për punën dhe angazhimin, e këto vlera në këtë organizatë

nuk kanë munguar asnjëherë, prandaj të jesh pjesë e SBASHK-ut, me krenari mund të them se ndjem krenare. E viti 2016 – që nga dita e parë e deri më sot, çdo ditë e re fillonte me punët dhe palët, ku jam munduar që në mënyrën me të zellshme të kryej çdo punë me përkushtimin tim maksimal, duke mos kursyer veten asnjëherë, por të jem gjithnjë aty ku ka nevojë dhe ku mund të ofroj kontributin tim për këtë organizatë. Mundohem t'a meritoj respektin, sepse s'thuhet kot: Djersja e punëtorit është më e vlefshme se parfumi i dembelit!

Dhe urimi im për vitin e ri 2017 është : Zbukuroni pemën sot, dhe mendjen mot!

Gëzuar 2017



Vlora Rexhepi Berisha – Asistente

Vitin që po lëmë pas e vlerësoj shumë, ngase pata rastin që me anë të takimeve dhe vizitave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, të mësoj edhe më shumë rreth punës sindikale dhe arsimit në përgjithësi, e kjo fal SBASHK-un që me punë dhe përkushtim synon ngritjen e cilësisë si të stafit të vet po ashtu edhe të të gjithë të punësuarve në sistemin arsimor në Kosovë.



Afërdita Mirena – Ahmeti, Administratore

Nga viti 2009 kam qenë prezente në sindikatë të arsimit, ku edhe kam fituar njohuri të mjaftueshme rreth çështjeve që kanë të bëjnë me arsimin. Çdo ditë këtu ka qenë sfidë në vete, duke pasur parasysh që arsimi është një profesion kaq i brishtë dhe kaq i rëndësishëm. Jam munduar të jem



Blendor Shatri – Jurist në SBASHK.

Puna ime në SBASHK është një kënaqësi e veçan ngase vazhdimisht jam në kontakt me palët të cilat kanë besim tek SBASHK-u dhe prandaj është e natyrshme që kërkojnë përkrahjen dhe mbështetjen tonë për zgjidhjen e problemeve të tyre nga marrëdhënia e punës. Ka raste të shumta individuale që I kemi mbështetur dhe kemi arritur ti zgjedhim ne të mirë të anëtareve tanë.

Falënderoj shumë SBASHK-un për korrektësinë dhe mundësitë e mira që më ofroi çdoherë për më shumë se 11 vite.

Arritje gjatë vitit 2016 mund ta përmendi shtimin e anëtarësisë në SBASHK, gjë që rezulton nga puna me përkushtim e gjithë stafit tonë, duke uruar që në vitin e ardhshëm të arrijmë edhe më shumë.

Është mirë kur je në mesin e kolegëve dhe stafit drejtues kaq modest dhe shtytës për të arritur më lartë çdo herë e më shumë, duke mos kursyer as një gjë nga vetja tyre, duke bashkëpunuar me të gjithë njësoj, pa dallim pozite. Për këtë jemi këtu ku jemi, jemi bashkë e në SBASHK. Gëzuar Vitin e Ri 2017!

maksimalisht e angazhuar në detyrën time, që të kontriboj sa më shumë për mësimdhënësit. Profesionin e mësuesit është profesioni më i vlefshëm në botë, andaj edhe pse nuk jam mesuese, jam përballur çdo ditë me këtë profesion dhe në një formë jam mishëruar me këtë duke qenë gjithmonë aktive në plotësimin e kërkesave të mësimeve në aspektin administrativ. Ndihej e lumtur që jam pjesë e SBASHK-it, një organizatë që mbron mësimdhënësit dhe punon pa ndal për mirëqenien e tyre, angazhohet jashtëzakonisht shumë për cilësinë në arsim dhe mbron të drejtat e mësimeve.

Por do të veçoja aktivitetin për përgatitjen e shkresave dhe dokumenteve të nevojshme në përpjekje që të realizojmë me dialog ose në rast se dialogu nuk jep rezultatet e pritura atëherë përmes organeve gjyqësore, për çështjen e Pagave për përcjellje në pension si dhe pagave si shpërblime jubilarë, anëtarët tanë të pensionuar gjatë viteve 2015 dhe 2016.

E konsideroj të suksesshëm për SBASHK-un vitin 2016 I vetëdijshëm se edhe në vitin 2017 na pret punë e madhe, por bashkërisht do ja dalim.

Gjatë muajit

Aktivitete e angazhime të shumta të SBASHK-ut gjatë vitit 2016

Përfaqësim dinjitoz kudo në Kosovë dhe jashtë vendit

Lexues të nderuar SBASHK-u e shënon vitin 2016 me shumë aktivitete e angazhime në shërbim të anëtarësisë dhe realizimit të kërkesave të tyre legjitime. Po ashtu SBASHK-u në shenjë respekti për angazhimet dhe zërin e fuqishëm sindikal është ftuar në shumë takime me rëndësi në vend dhe në nivelin ndërkombëtar. Për ju do të kthejmë kujtesën në ngjarjet më të rëndësishme.

Takime me Kabinetin Qeveritar të Kryeministrit Mustafa

Gjatë gjithë këtij viti përfaqësues të SBASHK-ut nuk kanë pushuar se angazhuari në përpjekje për të realizuar kërkesat nga Kontrata Kolektive dhe për të arritur marrëveshje me Qeverinë për angazhim të përbashkët rreth Projektligjit për statutin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99. Në kuadër të këtyre përpjekjeve do veçuar takimin me Kryeministrin Mustafa, zv/Kryeministrat e atëhershëm Hashim Thaçi e Kujtim Shala dhe Ministrat Arban Abrashi e Arsim Bajrami. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe Kryesia dhe anëtarët e këshillit Drejtues.



Kryeministri Isa Mustafa duke vlerësuar këtë takim ka shprehur gatishmërinë e Kabinetit Qeveritar që të angazhohen që përmes dialogut e takimeve të vazhdueshme me SBASHK-un për zgjidhjen e të gjitha kërkesave. Kryeministri ka lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut.



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj në këtë takim para Kryeministrit Mustafa dhe Kabinetit qeveritar ka kujtuar arritjet, por është ndalur edhe të kërkesat legjitime të SBASHK-ut që presin të gjejnë zgjidhje.

Takimet vazhdonin edhe për kërkesa të tjera të anëtarësisë

SBASHK-u ka vazhduar edhe në ditët e muajt në vijim me angazhime dhe takime me Ministrat nga Ministri të ndryshme. Nga takimet e shpeshta ishin ato me Ministrin Abrashi dhe me Ministrin Kujtim Shala në përpjekje për të tejkaluar defektin që kishte ndodhur lidhur me pensionet e një pjese të mësimdhënësve të Kosovës, që nuk po gëzonin pensionin e plotë.



Falë angazhimit të vazhdueshëm të SBASHK-ut dhe të Ministrave Shala e Abrashi u arrit marrëveshja për njohjen faktike të viteve të 90-ta si vite kontributdhënëse dhe mësimdhënësit në fjalë fituan me meritë të drejtën për pensione të plota pune.



Takime të shumta pune delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë zhvilluar gjatë këtij viti me Ministrin e MASHT, Prof. Dr. Arsim Bajrami dhe me anëtarë të Kabinetit të tij. Shumica e takimeve janë zhvilluar në frymën e përpjekjeve të përbashkëta në shërbim të arsimit në Kosovë.



Delegacioni i SBASHK-ut çdo herë në këto takime ka shkuar me kërkesa konkrete. Ministri Bajrami ka bërë angazhime në zgjidhjen e tyre dhe për këtë ka mbajtur edhe takime me kryetarët e qeverive lokale të komunave të Kosovës dhe me drejtorë të Drejtorive Arsimore. Ai në këto takime edhe ka adresuar obligimet e komunave ndaj Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar.



Po ashtu janë diskutuar edhe tema të tjera dhe falë mirëkuptimit të dyanshëm përfaqësues të

SBASHK-ut janë të pranishëm në takimet e DKA-ve , por edhe në Komisione e Këshilla që kanë të bëjnë me arsimin. Do theksuar se palët kanë ruajtur respektin ndaj njëra-tjetres edhe në momentet nuk kanë pasur qëndrime të ndryshme ndaj çështjeve siç ishte rasti me kundërshtimin kategorik e të fuqishëm të SBASHK-ut kundër idesë për testimin e me shkrim të mësimdhënësve. Në kuadër të takimeve me Ministrin Bajrami u shtrua edhe çështja e tekstit të ri të Kontratës Kolektive, pasi që Kontratës aktuale i skadon afati dhe në kuadër të kësaj edhe u punua nga SBASHK-u Drafti i Kontratës së re dhe ai ndodhet në MASHT te komisioni i caktuar nga Ministri dhe shpejt priten edhe takimet dhe negociimi për Kontratën e re, e cila tani është më e plotë sepse përfshinë, krahas Arsimit parauniversitar edhe Arsimin e Lartë.



Takime edhe me kryetarët e Grupeve Parlamentare

Përfaqësuesit e SBASHK-ut, kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, nuk kanë lënë derë pa trokitur , siç thotë populli , në përpjekje për të gjetur përkrahje sa më të madhe të institucioneve e subjekteve politika parlamentare lidhur me Projektligjin për statutin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.



Në kuadër të këtij angazhimi ata janë takuar fillimisht me kryetarin e atëhershëm të Grupit parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, pastaj edhe me kryetarin e tanishëm të këtij Grupi Parlamentar Zenun Pajaziti për të vazhduar me kryetarin e Grupit parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, me Glauk Konjufcën , kryetar i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes dhe me Pal Lekajn, kryetar i Grupit parlamentar të AAK-së dhe znj. Valdete Bajrami, kryetare e Grupit Parlamentar të Nisma.



Në të gjitha këto takime dhe në takimet me deputet veç e veç delegacioni i SBASHK-ut ka shpalosur shqetësimet anëtarësisë e veçmas lidhur me fatin e ligjit për statusin e mësimdhënësve shqiptar të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta.



Grabovci, Pajaziti, Beqiri , Konjufca dhe Bajrami i kanë dhënë përkrahje të plotë angazhimit të SBASHK-ut dhe kanë shprehur mbështetjen e tyre dhe deputetëve nga subjektet politike, që përfaqësojnë lidhur me Projekligjin duke u shprehur se do ta votojnë atë me të ardhur në Parlament.



Angazhime e arritje të SBASHK-ut edhe në Universitetet e Kosovës

Aktivitet i vazhdueshëm i SBASHK-ut është vërejtur gjatë gjithë vitit 2016 edhe në Universitetet e Kosovës. Zëri dhe aktivitetet i SBASHK-ut ka gjetur mbështetje, përveç në Universitetin e Prishtinës, edhe në atë të Prizrenit, Mitrovicës e Universitetet të tjera.



Për të krijuar një atmosferë bashkëpunimi e mirëkuptimi në shërbim të të punësuarve në këto institucione të arsimit të lartë janë zhvilluar takime me rektorin Marjan Demaj , Ramë Vataj e Alush Musaj .



Takimet kanë qenë në frymën e bashkëpunimit mes SBASHK-ut dhe kreut e organeve të këtyre institucioneve të dijes dhe palët janë pajtuar që të vazhdohet me bashkëpunimin në shërbim të arritjeve edhe më të mëdha dhe të plotësisht të kërkesave të anëtarësisë këtu përmes dialogut dhe frymës së mirëkuptimit.

SBASHK-u në mesin e sindikatave të arsimit të 44 shteteve evropiane

Konferencë zgjedhore e ETUCE-së



Mes 44 sindikatave nga shtetet e Evropës edhe SBASHK-u ishte pjesëmarrës

në Konferencën zgjedhore të ETUCE-s , që është mbajtur në Beograd. Mes 250 delegatëve nga 44 shtete të rajonit të Evropës, janë edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut, Ymer Ymeri dhe Vlora Rexhepi Berisha. Këtë ngjarje të madhe e shpalli të hapur kryetarja e ETUCE-së, Christine Blouer, e cila i ka përshëndetur delegatët



sindikalistë dhe iu ka dëshiruar mirëseardhje. Kishte ardhur në këtë ngjarje me

rëndësi për arsimin e Evropës edhe kryetarja e Internacionales Botërore të Arsimit, Susan Hopgood, e cila përshëndeti delegatët dhe foli për disa nga sfidat më të mëdha globale, duke përfshirë prioritetin e dhënë për interesat e korporatave, rritjen e ekstremizmit dhe erozionin e të drejtave qytetare. Ajo tha se mësimi ka një qëllim moral dhe më shumë ka të bëjë me promovimin e vlerave të përbashkëta si të njohurive dhe aftësive të transferimit. Ajo theksoi se mësuesit kishin një rol kyç në përmbushjen e sfidave globale.

Në vazhdim të punimeve, drejtori Evropian i ETUCE-së në largim, Martin Romer, prezantoi Raportin e Aktiviteteve me 160 faqe gjatë viteve 2012-2016. Ai pasqyroi "4 vite të vështira dhe të turbullta", duke cituar një përsëritje të mërzitshme të ngjarjeve dhe tendencave të cilat kanë ndodhur dhe që vijnë me sfida serioze. unanime e rizgjodhën Christine Blouer kryetare edhe për një mandat tjetër 4 vjeçar. Konferenca zgjodhi edhe nënkryetarët dhe organet tjera të ETUCE-s.

SBASHK-u kremtoi edhe 5 tetorin - Ditën Botërore të Mësuesit

Konferencë tematike në lartësim të personalitetit të mësuesit



Këtë vit SBASHK-u, krahas shumë aktiviteteve në shënim të ditës kombëtare të mësuesit dhe shkollës shqipe, i është bashkuar aktiviteteve Internacionales

Botërore të Arsimit duke organizuar një Konferencë tematike me rastin e Ditës Botërore të Mësuesit e në 50 vjetorin e Rekomandimeve të ILO/UNESCO mbi statusin e mësuesit. Këtë ngjarje të rëndësishme e kishin nderuar me pjesëmarrjen e tyre ministri i MASHT-it z. Arsim Bajrami me kabinetin e tij, kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim z. Nait Hasani, rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit z. Ramë Vataj, kryetari i Këshillit të Prindërve të Kosovës z. Bajram Beqiri, kryetari i BSPK-së z. Haxhi Arifi, drejtoresha e Arsimit të Prishtinës znj. Arbërie Nagavci, personalitete të tjera publike dhe mësimdhënës veprimtar të SBASHK-ut nga e tërë Kosova.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj në hapje të punimeve të Konferencës kishte kërkuar përkrahjen e pjesëmarrësve që SBASHK-u t'i drejtohet sekretarit të përgjithshëm të Edukimit Internacional z.Fred van Leeuwen, që në të gjitha shtetet e botës të lobohet me qëllim që në Asamblenë e Përgjithshme të radhës së UNESCO-së të votohet për pranimin e Kosovës në



këtë organizatë të rëndësishme të OKB-së. Kjo ide

SBASHK-u kremtoi në mënyrë madhështore ditën e mësuesit


Kujtesë për njerëzit e dijes e pendës



është aprovuar me duartrokitje frenetike nga pjesëmarrësit.

Këtë konferencë e kishin përshëndetur pastaj ministri i MASHT-it prof.dr.Arsim Bajrami duke përcjellë fillimisht urimin në emër të gjithë Qeverisë së Kosovës për mësuesit dhe këtë konferencë e ka vlerësuar si ngjarje të madhe.

Në këtë Konferencë Ministri Bajrami ka vlerësuar lartë edhe kontributin e SBASHK-ut në vitet më të vështira për Kosovën. Ministri para pjesëmarrësve është shprehur se është duke u punuar me të madhe



për finalizimin e Ligjit për statusin e mësimeve për vitet e '90ta. Është përcjellë me interesim të veçantë

prezantimi i prof. Agim Hasani, shef i Arsimit në komunën e Bujanovcit. Ai ka treguar për sfidat e mëdha dhe problemet e

shumta të arsimit shqip në tri komunat shqiptare atje.

Një aktivitet që është lavdëruar nga të gjithë ishte ceremonia festive për nder të 7 Marsit- ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe.

Të 557 anëtarët e SBASHK-ut të pensionuar nga marsi i vitit të kaluar e deri në marsin e këtij viti po ndjeheshin krenar dhe po shpalosnin kujtimet nga e kaluara duke u ndalur veçmas në punën dhe përkushtimin sublime në vitet e 90-ta në mbrojtje të arsimit dhe kulturës sonë nga furtunat e pushtuesit.



Kishin ardhur atë ditë në ceremoninë e organizuar nga SBASHK-u për të respektuar misionin e shenjtë të mësuesit Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z.Arban Abrashi, Këshilltari i Ministrit z.Arsim Bajrami, z. Azem Guri, Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë , z. Nevrus Kaptelli dhe mysafirë të tjerë të shumtë.



Në përmbyllje të këtij aktiviteti festiv kryetari i SBASHK-ut bashkë me Ministrin Abrashi, Këshilltarin e MASHT, Azem Guri, me z. Kaptelli dhe me Ymer Ymerin e Kadri Thaçin nga SBASHK, kishin ndarë mirënjohjet dhe nga një orë dore për nga një përfaqësues të secilës komunë. Aktiviteti ka vazhduar me ndarjen e orëve dhe mirënjohjeve për gjithë pensionistët e pranishëm të arsimit në këtë ceremoni.

Aktivitete të shumta në arenën ndërkombëtare **Konferencë për Paqen në Bullgari**

Përfaqësues të SBASHK-ut kanë përfaqësuar sindikatën e tyre dhe arsimin e Kosovës në mënyrë të denjë edhe në takimet ndërkombëtare kudo në shtetet e Ballkanit dhe Evropës.



Një takim i rëndësishëm ndërkombëtar i sindikatave të arsimit është zhvilluar në Sofje. Kolegët nga ky shtet kishin zgjedhur për konferencën e tyre një temë mjaft aktuale dhe sfiduese e që kishte të bënte me rolin e sindikatave për paqen në Ballkan.



SBASHK- në këtë konferencë me rëndësi është përfaqësuar nga kryetari Rahman Jasharaj, nënkryetari Lutfi Mani dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm , Ymer Ymeri. Edhe nikoqiri , por edhe sindikata pjesëmarrëse kanë dhënë shembuj të mirë të tolerancës dhe janë pajtuar që të vazhdojnë me bashkëpunimin dhe me kontributin për tolerancë , mirëkuptim dhe paqe në Ballkan.



Kryetari i SBASHK-ut në paraqitjen e tij ka deklaruar se Kosova është një shembull i mirë i tolerancës dhe kontributit për paqe. Ai ka thënë se institucionet e Kosovës dhe populli kurrë nuk do të lejojnë që dikujt tjetër t'i ndodh ajo që i ka ndodhur fëmijëve dhe popullit shqiptar në Kosovë gjatë luftës së fundit .

Mikpritje vëllazërore në Tiranë

Me ftesën e presidentit të Federatës së Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë, z. Xhafer Dobrushu , një delegacion i SBASHK-ut i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kishin marrë pjesë në ceremoninë festive me rastin e 25 vjetorit të formimit dhe aktiviteteve të FSASH. Në fjalën e tij Prof. Dr. Dobrushu ka bërë një shpallje të momenteve të rëndësishme nga angazhimi dhe arritjet e sfidat e FSASH. Ai ka kujtuar momente të shumta të angazhimit të sindikatës që drejton në shërbim të arsimit shqiptar dhe të anëtarësisë së kësaj sindikate.



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj në fjalën përshëndetëse kishte përgëzuar z. Dobrushu dhe gjithë kolegët sindikalistë shqiptarë për arritjet dhe ka shprehur bindjen se edhe në të ardhmen të dy sindikatat do të vazhdojnë me bashkëpunimin vëllazëror.



Jasharaj edhe në këtë takim ka kujtuar kohët e vështira të Kosovës duke u shprehur se sa herë ka takime të përbashkëta me kolegët në Shqipëri kthehen kujtimet në ato vite të vrara dhe me krenari kujtohet zemra e madhe e gjithë Shqipërisë, që strehoi e i ndihmoi vëllezërve nga Kosova të shërojnë plagët e luftës.

Mikpritje dhe përkrahje nga sindikata e arsimit gjerman GEW

Të mbështetur nga GIZ një delegacion 6 anëtarësh i SBASHK-ut, i kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj në shtatorin e këtij viti kanë qëndruar në disa qytete të Gjermanisë dhe janë takuar me udhëheqës sindikalë, me mësimdhënës e me përfaqësues të institucioneve shtetërore të Gjermanisë.



Ky delegacion fillimisht është pritur nga kryetarja e sindikatave gjermane të arsimit GEW, Znj. Tepe, e cila i ka dëshiruar mirëseardhje delegacionit të SBASHK-ut e pastaj në një bisedë miqësore me ta ka shprehur përkrahjen e plotë të sindikalistëve të arsimit gjerman për SBASHK-un.



Kryetari i SBASHK-ut edhe kësaj radhe ka falënderuar sindikatën e arsimit gjerman për përkrahjen në kohët më të vështira për Kosovën dhe është shprehur i bindur se bashkëpunimi mes dy sindikatave do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



Pas kësaj delegacioni nga Kosova i shoqëruar nga veprimtari sindikal Fisher dhe veprimtarë të tjerë kanë vizituar shumë shkolla, Akademinë për Trajnimin e mësimeve dhe Parlamentin dhe institucionet të tjera të rëndësishme. Gjatë gjithë takimeve janë këmbyer përvoja mes sindikatave të këtyre dy shteteve mike.



Pjesëmarrje në Kongresin V të Sindikatës së Arsimit të Malit të Zi

Delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga nënkryetari Lutfi Mani dhe menaxheri për financa e administratë Ymer Ymeri kanë marrë pjesë në Kongresin e pestë të Sindikatës së Arsimit të Malit të Zi.



Gjatë qëndrimit në Podgoricë delegacioni i sindikatës sonë ka pasur takime me kreun e sindikatës mikpritëse dhe me delegacione nga sindikata të shteteve të ndryshme të Ballkanit dhe Evropës dhe janë pajtuar që të shtohet edhe më shumë bashkëpunimi mes sindikatave të këtyre vendeve dhe SBASHK-ut.



Po kujtojmë këtu edhe Konferencën shkencore në Tiranë për autorin e himnit turk me prejardhje shqiptare Mehmet Akif duke mos harruar edhe shumë aktivitete e prezantime të denja të SBASHK-ut kudo në Kosovë dhe në vende të tjera.

Tradita e mirë vazhdon

SBASHK-u edhe këtë vit ka vazhduar me traditën e mirë të dërgimit të anëtarëve nga e tërë Kosova për pushime të merituar në bregdetin e bukur shqiptar.



Për këtë aktivitet kemi shkruar gjerësisht lexues të nderuar. Po kujtojmë se këtë vit në pushime SBASHK-u ka dërguar 420 të sindikalistë që ishin përzgjedhur nga shkollat e tyre nga të gjithë komunat e Kosovës. Pushuesit kanë vlerësuar lartë këtë aktivitet dhe shumë pushues përshtypjet i kanë bartur në fletoret e përshtypjeve të cilat ruhen me kujdes në arkivin e SBASHK-ut.



Në gazetën festive nuk mund të mos kujtohet edhe angazhimi i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë që duke lidhur marrëveshje me bizneset private dhe me institucione private shëndetësore e rekreative në Kosovë e Shqipëri për zbritje çmimesh për shërbimet e tyre për anëtarët e SBASHK-ut. Janë arritur deri tani

127 marrëveshje të tilla dhe numri i tyre sa vjen e shtohet.



Po në këtë gazetë festive po kujtojmë edhe faktin se numri i anëtarëve të SBASHK-ut edhe këtë vit ka shënuar ngritje të vazhdueshme. Kjo na shton obligimet për angazhime edhe më të mëdha, por na shton edhe forcën karshi sfidave që na presin.

Arritje e mirë për SBASHK-un është edhe përfundimi i ciklit të trajnimeve me sindikalistë nga të gjitha komunat e Kosovës. Këto trajnime janë vlerësuar lartë



sepse kanë përgatitur kuadro sindikale për dialogun social, por edhe kanë dhënë mundësinë e bashkëbisedave e dhënies së ideve nga pjesëmarrësit lidhur me punën dhe aktivitetet në vijim.

